

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.07.2023*

**21.07.2023
Ora 12:12**

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin vetëdeklarues z. Ilir Vilson Hysi, kandidat për deputet i propozuar nga subjekti Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Vlorë”.

Projektvendime: “Për plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
 - **Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
 - **Stafi KQZ: Z. Y. Merkaj, P. Doçaj**
- **Parti Politike: S’ka prezent**
- **Të tjerë: KRIIK**

Z. I. Celibashi: Mirëdita, në seancën e sotme kemi shqyrtimin e çështjeve që lidhen me plotësimin e vakancave në disa këshilla bashkiakë.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin dhe zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin, për funksionet publike si dhe përpunimin për formularin e deklaramit të disa subjekteve ndër të cilët edhe deputet i Kuvendit të Shqipërisë. Në zbatim të këtyre dispozitave të ligjit numër 138/2015, zoti Ilir Hysi kandidat i propozuar për deputet nga Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Vlorë ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve formularin e vetëdeklarimit me numër unik 717. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë verifikimin paraprak dhe ka konstatuar se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit dhe me vendimin numër 147 datë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.07.2023*

16.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve është miratuar lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, për Qarkun Vlorë për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Nga verifikimi i formularëve të vetëdeklarimit, rezulton se subjekti vetëdeklarues ka deklaruar në rubrikën e të dhënave personale, ndryshimet e gjeneraliteteve nga “Ilirjan” në “Ilir” dhe ka deklaruar masa shtrënguese jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në Novara të Italisë. Nga konstatimet e mësipërme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent për verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Në datën 03.07.2023 Drejtoria e Kordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin për miratimin e rezultatit të verifikimit për subjektin zotin Ilir Hysi, ku konstatohet se:

- nuk rezulton të jetë i dënuar nga autoritetet gjyqësore shqiptare;
- nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga një autoritet Shqipëtar ose i huaj;
- rezulton të ketë qenë në hetim në Itali;
- rezulton të ketë qenë i arrestuar në qytetin Novarë/Itali për veprën penale trafikim i lëndëve narkotike;
- nuk rezulton të ketë masë shtrënguese sigurie personale;
- nuk rezulton të ketë urdhër kërkimi ndërkombëtar;
- nuk rezulton të jetë i dëbuar nga territor i ndonjë shteti të huaj.

Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit në rezultatin e verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme konstatohet se: zoti Ilir Hysi, kandidat nga lista shumemërore e Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, Qarku Vlorë nuk ka marrë mandat deputeti.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.07.2023*

Gjithashtu subjekti zgjedhor Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, referuar nenit 162 dhe 168 të Kodit Zgjedhor nuk ka mandat në Qarkun e Vlorës. Në këto kushte, kur subjekti vetëdeklarues, kandidat i listës shumemërore nuk do të mund të përfitojë mandatin në Qarkun e Vlorës në këtë legjislacion, Komisioneri nuk mund të shprehet me vendim për çështjen objekt shqyrtimi. Në zbatim të nenit 10 dhe 11, të ligjit numër 138 /2015 si dhe nenit 90 dhe 95 të Kodit Procedural vlerësohet se ka humbur objekti dhe qëllimi i procedurës administrative të filluar përpara ditës së zgjedhjeve. Në këto kushte i propozojmë Komisionerit deklarin e procedurës administrative pa përfunduar dhe pa vendim përfundimtar të subjektit vetëdeklarues zotit Ilir Vilson Hysi, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Relatoni dhe të tjerat!

Z. Y. Merkaj: Këshilli Bashkisë: Shkodër, Përmet, Memaliaj, Dibër për dy vakanca, për dy vakanca dhe të Bashkisë Pukë, kanë njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancave në këto këshilla përkatëse për shkak të dorëheqjes së disa këshilltarëve. Nga verifikimi i formularëve të deklaramit të cilët kanë deklaruar kandidatët për antarë të këshillit bashkiak, rezulton se asnjëri prej tyre nuk ka deklaruar të dhënat të cilat kanë të bëjnë me ndalimet e parashikimeve të ligjit nr. 138/2015. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe zyra e gjendjes gjyqësore për të gjithë kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë përkatës. Në përgjigje të kërkesës sonë rezulton se asnjë prej kandidatëve nuk ka ndryshim të përbërjes së gjendjes civile si dhe nuk rezulton i dënuar me vendim penal të formës së prerë. Në këto kushte, në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, konstatohet se të gjithë kandidatët e këshillave bashkiakë përkatës, nuk përbëjnë kusht për mos

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.21.07.2023*

zgjedhjen e tyre në funksionin e këshilltarit. Bashkëlidhur keni projektvendimet për shqyrtim e miratim, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Mirë atëherë përsa i përket pikës së parë të rendit të ditës sipas propozimit vendosim:

- Deklarimin e procedurës administrative të përfunduar dhe pa vendim përfundimtar për subjektin vetëdeklarues zotin Ilir Vilson Hysi.

Në lidhje me plotësimin e vakancave në këshillat bashkiakë, vendosim:

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Shkodër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zotin Erald Erkoçaj.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Përmet me kandidatin nga lista shumemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, zonjën Valbona Muhaj.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Memaliaj me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zonjën Lauresha Lila.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate zotin Adriatik Merdini.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Dibër me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate zotin Leonida Gjura.

- Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Krujë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zonjën Anila Shehu.

-Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Krujë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Ardhmëria Shqiptare zonjën Anila Veseli.

- Dhe e fundit plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Pukë me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate zonjën Aida Cenaj.

Çështje të tjera nuk kemi?! Seanca mbyllet, ditë të mbarë!

Vendimi nr. 709 - 717

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*